**VENDIM**
**Nr. 214, datë 9.4.2025**

# PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 709, DATË 12.10.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES 'PËR KËRKESAT DHE KRITERET PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENCISË SË UDHËTIMIT'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 48, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 709, datë 12.10.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Emërtimi "Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes" zëvendësohet me "Ministria e Turizmit dhe Mjedisit";

b) Emërtimi "Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut" zëvendësohet me fjalët "Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e turizmit".

2. Në nenin 2 të rregullores, që i bashkëlidhet këtij vendimi, bëhen këto ndryshime:

a) Fjalia hyrëse e nenit 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Personi fizik ose juridik, që ushtron veprimtarinë si agjenci udhëtimi, përveç kritereve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 48, të ligjit nr. 93/2015, zbaton edhe kërkesat dhe kriteret e mëposhtme:";

b) Në pikën 12, fjalët "... pranë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, në përputhje me nenin 17, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin, dhe rregulloren për trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave" zëvendësohen me "... pranë strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e turizmit.".

II. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**